



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P.201/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.06.2020 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Alba Light” shpk nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-54750-03-24-2020, me objekt “*Blerje materiale elektrike per ndricimin rrugor*”, me fond limit 8,333,333 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 30.04.2020 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Shërbimeve Publike Berat.

**Ankimues:** “Alba Light” shpk  
Rrugo “Teodor Keko”, godina Pelivani, Kati.1,  
Kashar/Yzberisht, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Berat  
Lagja nr. 1 Kombinat Rruga “Baki Gjebrea”, Berat

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik

nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 24.03.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr.REF-54750-03-24-2020, me objekt “Blerje materiale elektrike per ndricimin rrugor”, me fond limit 8,333,333 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 30.04.2020 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Berat.

II.2. Në datën 30.04.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 14.05.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Klosi-R Company	6,300,000	I skualifikuar
- Fredi Electronic	6,662,000	I skualifikuar
- Ervin Luzi	6,900,000	I skualifikuar
- Euro-Alb	6,933,500	I skualifikuar
- Rafin Company	6,997,500	I kualifikuar
- Alba Light	7,502,900	I skualifikuar

- Murati D 7,544,200 I skualifikuar
- Hest 7,851,400 I skualifikuar
- Novamat 7,881,610 I skualifikuar
- ITE Grup 8,026,300 I kualifikuar
- Albaelectrica 8,186,764.60 I skualifikuar

II.4. Në datën 14.05.2020 operatori ekonomik “Alba Light” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.

- *Ne Formularin e Ofertes sipas Shtojces 1 ne DST Artikulli nr.2 Llamba Led 50 Ë duhet te ishte Llamba Led 40 Ë sipas kriterëve qe jane kerkuar dhe ne Shtojce.*

II.5. Në datën 21.05.2020 operatori ekonomik ankimues “Alba Light” shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Në lidhje me arsyen e skualifikimit Ne Formularin e Ofertes sipas Shtojces 1 ne DST Artikulli nr.2 Llamba Led 50 Ë duhet te ishte Llamba Led 40 Ë sipas kriterëve qe jane kerkuar dhe ne Shtojce*
- *Në shtojcën mbi modiifikimin e kriterëve të vecanta të kualifikimit është parashikuar:  
**Në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik ky kriter ishte :***
- 1. *Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën e vlefshme te leshuar nga organizma te akredituara, për menaxhimin e sigurisë në punë dhe të shëndetit **OHSAS 18001:2007** për tregtimin dhe mirëmbajtjen e mallrave objekt prokurimi.*

***Ky kriter behet:***

1. *Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën e vlefshme te leshuar nga organizma te akredituara, për menaxhimin e sigurisë në punë dhe të shëndetit **OHSAS 18001:2007** për tregtimin dhe mirëmbajtjen e mallrave objekt prokurimi ose çertifikatën ekuivalente të njohur nga Standardet shqiptare ISO 45001-2018.*

***Specifikimet e kerkuar ishte :***

<i>Nr</i>	<i>Emertimi i mallit</i>	<i>Njesia</i>	<i>Specifikimet e mallit</i>
<i>1</i>	<i>Ndricues Led 100 Ë</i>	<i>Cope</i>	<i>Ndricues Tallin Led 100ë Rrugor Me Trup Alumini</i>
<i>2</i>	<i>Llamba Led 50Ë</i>	<i>Cope</i>	<i>Llampe Led 40ë 3000k E27 100-240v E27-E40 Adapter</i>
<i>3</i>	<i>Llamba Led 30Ë</i>	<i>Cope</i>	<i>Llampe Goccia Saving Led 30ë E27 6.5k</i>

4	Llamba Led 18ë	Cope	Llampe Led Goccia 18ë E27 6.5k
5	Llamba 250 Ę sodium	Cope	Llampe Natriumi Me Shkarkim Nav-T 250ë E40 4y
6	Llamba 150 Ę sodium	Cope	Llampe Natriumi Me Shkarkim Nav-T 150ë Super E40
7	Llamba 125 Ę sodium	Cope	Llampe Merkuri Hql 125ë E27
8	Llamba 100 Ę sodium	Cope	Llampe Natriumi Me Shkarkim Nav-T 100ë Super E40
9	Llamba prozhektor 70 Ę sodium	Cope	Llampa Rx7s 70ë 2000k Hdls-High Press. Sodium Tub
10	Llamba prozhektor 150 Ę argon	Cope	Llampe Halogjene Hqi-Ts 150ë Rx7s Metal Halide
11	Automat 25 A	Cope	Automat 1p C25a 6ka
12	Leshues 65 A kater polar	Cope	Kontaktor Modular 63a, 4p, 230v
13	Injektor	Cope	Ndezes Per Llambat Nga 35ë Deri 400ë
14	Fotoelement	Cope	Sensor Muzgu 220v 1200
15	Kabell 4x10	ml	Kabell Fleks. Antizjarr 4x10 Fg16or16
16	Kabell 4x6	ml	Kabell Fleks. Antizjarr.4x6mmq Fror
17	Kabell 4x4	ml	Kabell Fleks. Antizjarr.4x4mmq Fror
18	Kabell 2x2.5	ml	Kabell Fleks.Antizjarr.2x2.5mmq Fror
19	Kabell 2x1.5	ml	Kabell Fleks. Antizjarr.2x1.5mmq Fror
20	Tel Ø 6	ml	Tel Fleks Antizjarr. 1x6 Fs17 Bl B
21	Tel Ø 4	ml	Tel Fleks Antizjarr 1x4 Bl Fs17 B
22	TelØ 2.5	ml	Tel Fleks Antizjarr 1x2.5bl Fs17 B
23	Llamba 70 Ę argon	Cope	Llampa Hdli-Ts Rx7s 70ë 4200/Ndl Metal Halide
24	Portollamba	Cope	Portollampe E27
25	Nastro	Cope	Nastro izolant 0.15mm x 19mm x 25m
26	Automat 65 A kater polar	Cope	Automat 4p C63a 6ka
27	Shllanga Ø 50	ml	Tub Cavidotto D.50 Corrugato Doppia Parete

28	<i>Prozhektor 50Ë</i>	<i>Cope</i>	<i>Ndricules 50ë Prozhektor Ip65 Oem Black</i>
29	<i>Rrip Sigurimi</i>	<i>Cope</i>	<i>Rrip Sigurimi</i>
30	<i>Krah metalik Ø50</i>	<i>Cope</i>	<i>Krah Metalik 150cmx150cm fi Ø60mm</i>

**Behet:**

<i>Nr</i>	<i>Emertimi i mallit</i>	<i>Njesia</i>	<i>Specifikimet e mallit</i>
1	<i>Ndricules Led 100 W</i>	<i>Cope</i>	<i>Ndricules Tallin Led 100ë Rrugor Me Trup Alumini</i>
2	<i>Llamba Led 40W</i>	<i>Cope</i>	<i>Llampe Led 40ë 3000k E27 100-240v E27-E40 Adapter</i>
3	<i>Llamba Led 30W</i>	<i>Cope</i>	<i>Llampe ruajtes Led 30WE 27 6.5 k</i>
4	<i>Llamba Led 18W</i>	<i>Cope</i>	<i>Llampe Led 18W E27 6.5k</i>
5	<i>Llamba 250 Ë sodium</i>	<i>Cope</i>	<i>Llampe Natriumi Me Shkarkim Nav-T 250ë E40 4y</i>
6	<i>Llamba 150 Ë sodium</i>	<i>Cope</i>	<i>Llampe Natriumi Me Shkarkim Nav-T 150ë Super E40</i>
7	<i>Llamba 125 Ë sodium</i>	<i>Cope</i>	<i>Llampe Merkuri Hql 125ë E27</i>
8	<i>Llamba 100 Ë sodium</i>	<i>Cope</i>	<i>Llampe Natriumi Me Shkarkim Nav-T 100ë Super E40</i>
9	<i>Llamba prozhektor 70 Ë sodium</i>	<i>Cope</i>	<i>Llampa Rx7s 70ë 2000k Hdls-High Press. Sodium Tub</i>
10	<i>Llamba prozhektor 150 Ë argon</i>	<i>Cope</i>	<i>Llampe Halogjene Hqi-Ts 150ë Rx7s Metal Halide</i>
11	<i>Automat 25 A</i>	<i>Cope</i>	<i>Automat 1p C25a 6ka</i>
12	<i>Leshues 65 A kater polar</i>	<i>Cope</i>	<i>Kontaktor Modular 63a, 4p, 230v</i>
13	<i>Injektor</i>	<i>Cope</i>	<i>Ndezes Per Llambat Nga 35ë Deri 400ë</i>
14	<i>Fotoelement</i>	<i>Cope</i>	<i>Sensor Muzgu 220v 1200</i>
15	<i>Kabell 4x10</i>	<i>ml</i>	<i>Kabell Fleks. Antizjarr 4x10 Fg16or16</i>
16	<i>Kabell 4x6</i>	<i>ml</i>	<i>Kabell Fleks. Antizjarr.4x6mmq Fror</i>
17	<i>Kabell 4x4</i>	<i>ml</i>	<i>Kabell Fleks. Antizjarr.4x4mmq Fror</i>

18	Kabell 2x2.5	ml	Kabell Fleks.Antizjarr.2x2.5mmq Fror
19	Kabell 2x1.5	ml	Kabell Fleks. Antizjarr.2x1.5mmq Fror
20	Tel Ø 6	ml	Tel Fleks Antizjarr. 1x6 Fs17 Bl B
21	Tel Ø 4	ml	Tel Fleks Antizjarr 1x4 Bl Fs17 B
22	TelØ 2.5	ml	Tel Fleks Antizjarr 1x2.5bl Fs17 B
23	Llamba 70 Ë argon	Cope	Llamba Hdli-Ts Rx7s 70ë 4200/Ndl Metal Halide
24	Portollamba	Cope	Portollampe E27
25	Nastro	Cope	Nastro izolant 0.15mm x 19mm x 25m
26	Automat 65 A kater polar	Cope	Automat 4p C63a 6ka
27	Shllanga Ø 50	ml	Tub dopjo veshje
28	Prozhektor 50Ë	Cope	Ndricules 50ë Prozhektor Ip65 Oem e zeze
29	Rrip Sigurimi	Cope	Rrip Sigurimi
30	Krah metalik Ø50	Cope	Krah Metalik 150cmx150cm fi Ø50mm

- Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar katalog ku pasqyrohet LlambaLed 40 ë sipas specifikimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor Lampë led 40 ë 3000k E27 100-240v E27-E40 Adapter.
- Në Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 23, pikat 1, 2 dhe 3 thuhet si më poshtë:
- “Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.
- 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.
- 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:
  - a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare,

- miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;*
- *b) kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*
  - *c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj.”*
  - *Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 1, thuhet se:*
  - *“Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.”*
  - *Sqarojmë se autoritetet kontraktore, në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Theksojmë se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit (parashikuar nga neni 2 gërma “b” dhe “c” e LPP-së) janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në respekt të parimit të mësipërm, specififikimet teknike në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi qoftë ato të dukshme qoftë ato të fshehta të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast specififikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/mall/shërbim që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.*
  - *Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specififikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27, pika 1 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Gjithashtu duke u ndalur në pikën 3 të nenit 23 të LPP-së, KPP gjykon se ligjvënësi ka parashikuar tre metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Konkretisht metoda e parë ka të bëjë me referimin e standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë,*

ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve.

- Metoda e dytë ka të bëjë me referimin e kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale. Gjithashtu edhe metoda e tretë e cila është një ndërthurje e dy metodave të mësipërme, por çdoreferencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Autoritet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë me përpikmëri dispozitën e mësipërme të LPP-së në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. KPP gjykon se nga interpretimi teleologjikarrijmë në përfundim se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurim të drejtë, të hapur dhe gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminuese për të gjithë operatorët ekonomikë si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.
- Operatori ekonomik ka dorëzuar në kuadër të zhvillimit të procedurës së prokurimit produkt i cili përmbush minimumin e specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në aspektin teknik produkti i kërkuar shfaq avantazhe për autoritetin kontraktor në drejtim të cilësisë së dritës dhe zgjidhjes teknologjike të ofruar nga shoqëria jonë ndërkohë që në nivel kursimi shfaq të njëjtat parametra si ato të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Nënvizojmë se procesi i hartimit të dokumentave të procedurës së prokurimit dhe shqyrtimit të tyre më pas nga KVO i nënshtrohet parimit të ligjshmërisë si një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit si dhe vetë të procedurës administrative në tërësi. Kështu vlerësimi i procedurës së prokurimit duhet ti nënshtrohet njëherazi edhe parashikimeve të nenit 27 të VKM nr.914/2014 e cila në mënyrë eksplicite parashikon se specifikimet teknike përshkruajnë minimumin e specifikimeve teknike të kërkuara, pra në interpretim gjuhësor produktet e dorëzuara duhet të përmbushin minimumin e specifikimeve teknike por në asnjë rast as ligji dhe as dokumentat e procedurës së prokurimit nuk shprehen se dorëzimi i produktit që përmbush specifikimet teknike dhe që është më i avancuar nuk do të pranohet.
- Sa më sipër kërkojmë pranimin e ankesës dhe kualifikimin e shoqërisë sonë.

II.6. Në datën 27.05.2020 me shkresën nr. 250 prot operatori ekonomik ankimues “Alba Light” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 05.06.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur,



## Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alba Light” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se *“Ne Formularin e Ofertes sipas Shtojces 1 ne DST Artikulli nr.2 Llamba Led 50 W duhet te ishte Llamba Led 40 W sipas kriterëve qe jane kerkuar dhe ne Shtojce”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

III.1.2. Parashikimi i nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër, KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në elementët e testit të legjitimitimit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë *interesi* i ankuesit, *dëmi real ose potencial i pritshëm* dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor *i marrë në kundërshtim me ligjin*.

III.1.3. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.1.4. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën.

III.1.5. Referuar pretendimeve në ankesë të ankimuesit, KPP konstaton se operatori ekonomik ankimues “Alba Light” sh.p.k pretendon vetëm kualifikimin e ofertës së tij. Referuar klasifikimit përfundimtar të ofertave, KPP vëren se operatori ekonomik ankimues “Alba Light” shpk ka ofertuar me cmim më të lartë se operatori ekonomik “Rafin Company” shpk i kualifikuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Mosankimimi lidhur me operatorin tjetër të kualifikuar “Rafin Company” shpk bën që operatori ekonomik “Alba Light” sh.p.k. të mos ketë mundësi të bëhet fitues i kontratës objekt ankimi edhe nëse arsyeja e skualifikimit të tij nuk qëndron për shkak se operatori ekonomik “Rafin Company” shpk ka ofertuar me vlerë më të ulët në këtë procedurë prokurimi.

Në këtë kuptim KPP gjykon se edhe në hipotezën se, pretendimi i parashtruar në ankimin e tij në lidhje me arsyen e skualifikimit, do të pranohet nga KPP, ankimuesi sërisht nuk do të ishte fitues i kontratës pasi operatori ekonomik “Rafin Company” shpk ka ofertuar me vlerë më të ulët në këtë procedurë prokurimi dhe rrjedhimisht do të jetë fituesi i kontratës.

Sa më sipër pretendimet e ankimesit lidhur me skualifikimin e tij nuk merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrative, pasi cilido qoftë fati i këtyre pretendimeve pala ankimuese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alba Light” shpk për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-54750-03-24-2020, me objekt “*Blerje materiale elektrike per ndricimin rrugor*”, me fond limit 8,333,333 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 30.04.2020 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Berat.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 521 Protokolli, Datë 05.06.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**